

01	1517
03	07.06.12



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Infrastrukturës
Ministarstvo Infrastrukture
Ministry of Infrastructure

Ministri i Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 8 paragrafi 1.2 dhe nenet 10, 22, 23, 46, 92 e 93. të Ligjit nr. 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës, nenin 38 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 dhe nenin 8, paragrafi 1.4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 03/2012
PËR LICENCIMIN E MENAXHERËVE TE INFRASTRUKTURËS HEKURUDHORE

Neni 1
Qëllimi

Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen kriteret, procedurat për lëshimin, pezullimin dhe revokimin e licencës për menaxherët e infrastrukturës hekurudhore të cilët ushtrojnë veprimtarinë e shërbimeve të infrastrukturës hekurudhore në Kosovë.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) është organ përgjegjës për licencimin e menaxherëve të infrastrukturës hekurudhore të cilët ushtrojnë veprimtarinë e shërbimeve të infrastrukturës hekurudhore në Kosovë.
2. ARH lëshon licencat për menaxherët e infrastrukturës hekurudhore në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese, jo më vonë se 90 (nëntëdhjetë) ditë pas pranimit të kërkesës.

Neni 3
Llojet e licencave vendor

1. ARH lëshon këto lloje të licencave për menaxherët e infrastrukturës hekurudhore në Kosovë:

- 1.1. Licencat për menaxhimin e rrjetit hekurudhorë dhe infrastrukturës hekurudhore (Licenca I).
- 1.2. Licencat për stacione dhe stacione për formim dhe shformim të trenave (stacionet ranzhiruese) (Licenca S)
- 1.3. Licencat për mirëmbajtjen e depove për mjetet lëvizëse hekurudhore dhe mjeteve tjera të mirëmbajtjes (Licenca M).
- 1.4. Licencat për operime të kombinuara të rrjetit hekurudhorë dhe infrastrukturës hekurudhore, për stacione dhe stacione për formim dhe shformim të trenave (stacionet ranzhiruese) (Licenca O).

Neni 4 Licencat Evropiane

1. Licencat e vlefshme për menaxher të infrastrukturës hekurudhore të lëshuara nga ndonjë organ licencues i Bashkimit Evropian do të konsiderohen të vlefshme në Kosovë, në qoftë se janë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës.
2. Pas pranimit dhe shqyrtimit të licencës Evropiane për menaxher të infrastrukturës hekurudhore, ARH e njofton mbajtësin e licencës brenda 30 (tridhjetë) ditëve, nëse licenca është në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

Neni 5 Licencat e Observatorit të Transportit për Evropën Jug-Lindore (SEETO-s)

1. Licencat e vlefshme për menaxher të infrastrukturës hekurudhore, të lëshuara nga organi licencues pjesëmarrës në SEETO, nënshkrues të Traktatit të Komunitetit për Transport të Evropës Jug-Lindore, do të konsiderohen të vlefshme në Kosovë, nëse ato janë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe Ministria pajtohet me Ministrinë e atij vendi për njohjen reciproke të licencave të lëshuara për sektorin hekurudhorë përderisa Traktati i Komunitetit të Transportit të Evropës Jug-Lindore nuk hyn në fuqi.
2. Pas pranimit dhe shqyrtimit të licencës për menaxher të infrastrukturës hekurudhore, ARH e njofton mbajtësin e licencës dhe Ministrinë brenda 30 (tridhjetë) ditësh, nëse licenca është në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

Neni 6
Licencat tjera të huaja

1. Licencat e vlefshme për menaxher të infrastrukturës hekurudhore të lëshuara nga ndonjë organ licencues i huaj do të konsiderohen të vlefshme në Kosovë në qoftë se janë në përputhje me legjislacionin e Kosovës.
2. Pas pranimit dhe shqyrtimit të licencës për menaxher të infrastrukturës hekurudhore, ARH e njofton mbajtësin e licencës dhe Ministrinë brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nëse licenca është në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

Neni 7
Tarifat e licencimit

Lëshimi i licencave për menaxher të infrastrukturës hekurudhore është falas gjatë pesë viteve të para, pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 8
Procedura, forma dhe dokumentet për aplikim

Të gjitha format dhe dokumentet tjera të nevojshme për dhënien e licencës për menaxher të infrastrukturës hekurudhore publikohen në faqen e internetit të ARH-së, në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe, 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 9
Publikimi i licencave

Licencat e lëshuara për menaxher të infrastrukturës hekurudhore publikohen në faqen e internetit të ARH-së.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim administrativ hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Infrastrukturës.

Prishtinë, 6 qershor 2012


Fehmi Mujota
Ministër i Infrastrukturës